



Oda e Avokatëve të Kosovës  
Advokatska Komora Kosova  
Kosovo Chamber of Advocates

**PLANI STRATEGJIK 5-VJEÇAR**  
**5-GODIŠNJI STRATEŠKI PLAN**  
**5-YEAR STRATEGIC PLAN**

Shkurt / Februar / February 2009







Oda e Avokatëve të Kosovës  
Advokatska Komora Kosova  
Kosovo Chamber of Advocates

**PLANI STRATEGJIK 5-VJEÇAR**  
**I**  
**ODËS SË AVOKATËVE TË**  
**KOSOVËS**

Shkurt 2009

Ky publikim është realizuar me përkrahjen zemërgjerë të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja e publikimit nuk pasqyron pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## **PARATHËNIE: PËRDORIMI I PLANIT STRATEGJIK 5-VJEÇAR TË OAK-së**

Ky plan strategjik 5-vjeçar i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) paraqitet në tre formate të ndryshme, secili i paraparë të maksimizojë shfrytëzimin e këtij plani për audiencën dhe zbatuesit e tij të ndryshëm. Plani, së pari paraqitet në formën e tij përshkruese duke dhënë shpjegime mbi metodologjinë e përdorur dhe përkufizimin në hollësi të caqeve dhe rezultateve të procesit të planifikimit strategjik të OAK-së. Pastaj, plani paraqitet në orarin A në formatin e një tablele në të cilën kategorizohen dhe përmbledhen hapat e ndryshëm të veprimit sipas secilit nga pesë rezultatet strategjike. Në fund, plani paraqitet pjesërisht në orarin B si një grup i përzgjedhur i kalendarëve vjetore, secili prej të cilëve pasqyron agjendën e punëve të parapara për disa prej komiteteve kryesore të OAK-së.

Zbatuesit e planit nxiten të shqyrtojnë secilin format, dhe ato pjesë të planit që janë relevante për detyrat e tyre specifike. Për shembull, gjersa drejtuesit e komitetit të caktuar mund të dëshirojnë që së pari të konsultojnë kalendarët vjetorë për atë komitet nga orari B me rastin e hartimit të agjendës vjetore të komitetit, ata këshillohen që ta shqyrtojnë kornizën tabelare nga orari A për vërtetuar shkallën e prioritetit që i caktohet secilës detyrë dhe marrëdhëniet e ndërsjella midis detyrave të komitetit të tyre dhe detyrave të komiteteve tjera të OAK-së. Në fund, shpjegimi përshkrues i detyrave ofron përshkrimin më të hollësishëm të vetë detyrave dhe arsyetimin e pjesëmarrësve në hartimin e planit, për caktimin e atyre detyrave në plan.

Ndihmuar nga Kevin Hoy dhe Daragh O’Shea nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës; Fatmir Kutllovci, Dawn Schock dhe Laura Berger nga Shoqata e Avokatëve Amerikan Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA ROLI) me përkrahjen nga Arben Isufi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>MISIONI I OAK-së</b> .....	<b>1</b>
<b>PLANI STRATEGJIK I OAK-së</b> .....	<b>1</b>
<b>1. Hyrje</b> .....	<b>1</b>
<b>2. Përmbledhje e Konkluzioneve</b> .....	<b>2</b>
2.2 Buxheti .....	2
2.3 Administrata e OAK-së .....	3
2.4 Lobimi .....	5
2.5 Disiplina dhe Etika .....	6
2.6 Ekselenca Ligjore .....	8
2.7 Zhvillimi dhe Shërbimet e Anëtarësisë të OAK-së .....	10
<b>3. Mbledhja – Metodologjia</b> .....	<b>13</b>
<b>4. Misioni i OAK-së</b> .....	<b>13</b>
<b>5. Vizioni i OAK-së</b> .....	<b>14</b>
<b>6. Caqet dhe Prioritetet e OAK-së</b> .....	<b>14</b>
<b>7. Zbatimi i Planit Strategjik</b> .....	<b>14</b>
<b>ORARI A – KORNIZA TABELARE</b> .....	<b>16</b>
<b>Rezultati Strategjik 1: Administrata e Përmirësuar e OAK-së</b> .....	<b>17</b>
<b>Rezultati Strategjik 2: Përmirësim i Lobimit/Avokimit/     Shqyrtimit Legjislativ</b> .....	<b>22</b>
<b>Rezultati strategjik 3: Disiplina dhe Etika</b> .....	<b>25</b>
<b>Rezultati strategjik 4: Ekselenca Ligjore</b> .....	<b>31</b>

<b>Rezultati Strategjik 5: Shërbimet dhe Zhvillimet e Përmirësuara në Anëtarësinë e OAK-së. ....</b>	<b>34</b>
<b>ORARI B: KALENDARËT VJETOR TË KOMITETEVE .....</b>	<b>40</b>
<b>Kalendari i Bordit Ekzekutiv 2009 .....</b>	<b>41</b>
<b>Kalendari i Bordit Ekzekutiv 2010 .....</b>	<b>42</b>
<b>Kalendari i Komitetit për Ngritje të Fondeve 2009 .....</b>	<b>43</b>
<b>Kalendari i Komitetit për Ngritje të Fondeve 2010 .....</b>	<b>44</b>
<b>Kalendari i Komitetit për Çështje Gjinore dhe të Pakicave 2009 .....</b>	<b>45</b>
<b>Kalendari i Komitetit për Çështje Gjinore dhe të Pakicave 2010 .....</b>	<b>46</b>
<b>Kalendari i Komitetit Legjislativ/Lobim 2009 .....</b>	<b>47</b>
<b>Kalendari i Komitetit Legjislativ/Lobim 2010 .....</b>	<b>48</b>
<b>Kalendari i Zhvillimit dhe Shërbimeve të Anëtarësisë 2009 .....</b>	<b>49</b>
<b>Kalendari i Zhvillimit dhe Shërbimeve të Anëtarësisë 2010 .....</b>	<b>50</b>

## MISIONI I OAK-së

Misioni i Odës së Avokatëve të Kosovës është, ta fuqizojë sundimin e ligjit në Kosovë duke siguruar praktikat më të mira dhe standardet më të larta të ushtrimit të ligjit, duke kontribuar dhe mbrojtur kështu sistemin gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, dhe duke promovuar kuptimin e publikut mbi ligjin dhe sistemin gjyqësor.

## PLANI STRATEGJIK I OAK-së

### **1. Hyrje**

1.1. Gjatë pranverës dhe verës së vitit 2008, Oda e Avokatëve e Kosovës (“**OAK**”), me ndihmën e Shoqatës së Avokatëve Amerikanë (“**ABA**”), ka filluar procesin e zhvillimit të planit strategjik 5-vjeçar për periudhën 2008 – 2013. Procesi i planifikimit strategjik ka përfshirë një numër komponentësh, sikur:

- Realizimi i anketës me anëtarësinë, e cila u është shpërndarë anëtarëve të OAK-së ku janë anketuar dhe kanë dhënë përgjigjet 89 anëtarë (“**Anketa me Anëtarësinë**”);
- Punëtorja dy ditore para-planifikuese, e mbajtur gjatë 14 dhe 15 korrikut 2008 (“**Punëtorja Para-planifikuese**”); dhe
- Mbledhja (tërheqja) e mbajtur gjatë 10, 11 dhe 12 tetorit 2008 (“**Mbledhja**”), me qëllim të caktimit të prioritetëve të OAK-së përkitazi me caqet e saj gjatë 5 viteve të ardhshme.

1.2 Komponentë të ndryshëm gjatë procesit të planifikimit strategjik kanë kulmuar gjatë **mbledhjes**. Rezultati i procesit të planifikimit strategjik – *p.sh.*, plani strategjik – është paraparë në këtë dokument strategjik (“**Dokument**”).

1.3 Kur lexohet ky dokument, duhet të theksohet se plani strategjik duhet të kuptohet si proces dinamik dhe konstant, duke rezultuar që ky **dokument**, me të cilin përcaktohet plani strategjik, të jetë dokument i gjallë. Kjo nënkupton se procesi i planifikimit strategjik nuk duhet të ndërpritet me prodhimin e këtij dokumenti dhe OAK duhet të përfshihet në planifikimin strategjik çdo ditë me radhë gjatë 5 viteve në vijim. Rrjedhimisht, plani strategjik vetvetiu duhet të ndryshojë dhe përshtatet gjatë 5 viteve të rrjedhës së tij. Ky proces duhet të zhvillohet natyrshëm krahas rivendosjes së prioritetëve përkitazi me caqet dhe krahas paraqitjes së sfidave dhe të cilat identifikohen nga OAK.

1.4 Vlera e procesit të planifikimit strategjik dhe procesi i të menduarit që e përcjell atë, do të zvogëlohej dukshëm nëse ky dokument dhe plan strategjik do të shndërrohej në proces përfundimtar dhe normativ. Kjo do të ndodhte nëse OAK dhe anëtarësia e saj nuk do të shpreheshin të gatshëm të rishqyrtojnë prioritetet e caqeve ekzistuese dhe të caktojnë caqe të reja nën dritën e rrethanave të



ndryshuara dhe informatave të reja. Për të evituar këtë, OAK dhe anëtarësia e saj duhet të jenë fleksibil dhe dinamike në qasjen e tyre për zbatimin e planit të tyre strategjik dhe për të parë përfitimet nga plani strategjik i cili më shumë flet për procesin se sa për një dokument final.

## **2. Përmbledhje e Konkluzioneve**

2.1 Të gjithë pjesëmarrësit e Mbledhjes kishin ide të fuqishme për atë se çfarë mendonin se ishin çështjet kryesore me të cilat ballafaqohet OAK dhe si do të duhej OAK t'i adresonte ato çështje gjatë pesë viteve të ardhshme. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të gatshëm t'i shkëmbenin ato ide me kolegët tjerë pjesëmarrës në mbledhje një diskutimi i gjallë e ka përcjellë gjithë mbledhjen. Kjo ishte e rëndësishme ngase demonstroi se OAK e ka një anëtarësi aktive dhe të angazhuar, të cilët janë të gatshëm të hyjnë në dialog në mes vete, dhe të cilët investojnë në ardhmërinë e OAK-së dhe profesionit ligjor në Kosovë. Detyra e mbledhjes ishte t'i distilojë çështjet e ndryshme dhe t'i shndërroj në vizion të OAK-së për pesë vitet e ardhshme, dhe bazuar në këtë vizion, t'i artikulojë caqet e OAK-së, në mënyrë të përshtatshme t'ua caktojë caqeve prioritetin, të përkufizoj veprimet specifike drejt arritjes së këtyre caqeve dhe përcaktimit të orarit për realizimin e tyre.

### **2.2 Buxheti:**

- (i) Që në fillim është me rëndësi të potencohet një nga çështjet më të ngutshme me të cilën ballafaqohet OAK, e që do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në aftësinë e saj për të arritur caqet e parapara me këtë dokument. Kjo çështje është buxheti, e në veçanti aftësia dhe gatishmëria e OAK-së për të ndarë mjete financiare për personat dhe komitetet që kanë marrë përsipër detyrat e realizimit të caqeve të OAK-së.
- (ii) Çështja e aftësisë së OAK-së për ndarjen e mjeteve buxhetore është problem të cilin e kanë të përbashkët të gjitha organizatat tjera. Respektivisht, mjetet financiare gjithmonë, diku më shumë diku më pak, janë të mangëta për të gjitha organizatat. Në këtë kontekst, nëse pritet që të arrihen caqet, si dhe të radhiten sipas prioritetëve, organizata konkrete duhet të ketë orientimin se cilat prej atyre burimeve të të ardhurave janë të pavarura dhe të qëndrueshme (*p.sh.*, pagesa e anëtarësisë) dhe cilat prej burimeve tjera janë më pak të besueshme (*p.sh.* financimi nga donatorët e jashtëm). Çështja e financimit nga donatorët e jashtëm ishte prekur në disa raste gjatë mbledhjes. Është bërë diskutim rreth faktit se gjersa për OAK-në financimi nga donatorët është një burim jetik për financimin e OAK-së, realiteti është se financimi nga donatorët e jashtëm nuk afatgjatë, i besueshëm ose i qëndrueshëm ngase nuk ka garanci se donatorët e jashtëm do të mbesin aktiv në Kosovë. Në raport me caqet e OAK-së të identifikuar në këtë dokument, të gjitha këto caqe nuk e kanë medoemos të njëjtën shkallë të prioritetit. Rrjedhimisht, burimet financiare duhet t'i përgjigjen në vazhdimësi caqeve sipas radhës së prioritetëve të tyre, me

ç'rast caqet e prioriteti më të lartë do të kenë financim të garantuar nga pjesa më e besueshme e buxhetit të gjithmbarshëm.

- (iii) Po ashtu, si çështje paraqitet edhe gatishmëria e OAK-së për të ndarë mjete buxhetore. Nëse OAK nuk është e gatshme t'i ndajë mjetet ekzistuese buxhetore për caqet e identifikuar në këtë dokument, aftësia e saj për të arritur cilindo prej këtyre caqeve do të cungohet në masë të konsiderueshme. Për OAK-në është kruciale që në mënyrë kolektive ta bëjë një hulumtim të thellë për atë se cilat janë prioritetet e vërteta në raport me ndarjen e buxhetit të vet dhe, veçanërisht që drejtuesit e OAK-së të hyjnë në dialog me anëtarësinë për vlerësimin e buxhetit karshi caqeve me prioritet, edhe nëse kjo nënkupton vonimin e objektivave tjerë të rëndësishëm që janë identifikuar si caqe strategjike me këtë dokument.

### 2.3 Administrata e OAK-së:

(i) Përgjatë procesit të planifikimit strategjik u bë evidente se OAK kishte nevojë për një reformë elementare organizative për t'u bërë një organizatë më e sofistikuar e anëtarësisë. OAK posedon ekspertizë ligjore për funksionuar si një organizatë juridike me ndikim, por duhet ta avancojë administratën organizative që me të vërtetë të ndikojë në profesion. Kjo reformë e administratës së organizatës do t'i mundësojë që në mënyrë efektive dhe efikase t'i përmbushë kërkesat e anëtarësisë dhe t'i përmbushë obligimet e veta ligjore. Drejtuesit e OAK-së e kanë parë këtë nevojë para se të fillojë procesi i planifikimit strategjik në verën e vitit 2008 dhe kishte filluar veprimet konkrete.

- a. Hapi i parë drejt kësaj reforme të gjerë është që t'i caktohet detyrë komitetit që të gjurmojë opsionet administrative dhe të zhvillojë një strukturë të re të sistemit organizativ. Ky komitet duhet të punojë në bashkëpunim me bordin ekzekutiv të OAK-së dhe duhet të konsultojë odat tjera të avokatëve dhe organizatat ndërkombëtare për të mësuar më shumë lidhur me sistemet e tyre organizative. Gjithashtu duhet të rishikojë politikat ekzistuese me të cilat rregullohet administrata dhe organet e OAK-së për të shikuar nëse këto politika janë në përputhje me nevojat e organizatës. Në bazë të këtij hulumtimi intensiv, komiteti do ta hartojë propozimin për politikat dhe sistemet e reja dhe këtë t'ia paraqet bordit ekzekutiv për miratim.
- b. Anëtarësia e OAK-së e ka shprehur interesimin e vet për decentralizimin e funksioneve të OAK-së. Kjo duhet të merret parasysh gjatë hulumtimit për reformën në administratë. Krijimi i strukturës së regjioneve kërkon jo vetëm reformim të politikave të OAK-së, por edhe një metodë transparente të ndarjes së qartë të përgjegjësisë dhe mjeteve, duke përfshirë edhe sigurimin e pajisjeve dhe personelit të ri.

(ii) Për momentin, OAK-ja komitetet i bën përgjegjëse për zhvillimin dhe realizimin e programeve të OAK-së. Kjo strukturë e komiteteve

shfrytëzohet globalisht edhe nga organizatat tjera të avokatëve. Mirëpo, që komitetet e OAK-së të jenë vërtetë efektive dhe që programet e OAK-së të jenë efikase, OAK duhet ta avancojë edhe më tej zhvillimin e strukturës së komiteteve. Është me rëndësi që komitetet ta ruajnë pavarësinë në mënyrë që të veprojnë në mënyrë efikase por njëkohësisht edhe të jenë të lidhura me drejtuesit e OAK-së.

- a. Secili komitet duhet të përfaqësohet në bordin ekzekutiv në mënyrë që të ketë mundësi të llojë për nevojat dhe prioritetet e atij komiteti me drejtuesit tjerë të OAK-së.
- b. Komitetet duhet që në fillim të vitit t'i hartojnë planet e tyre vjetore për aktivitetet dhe buxhetet. Ky plan dhe buxhet do të shqyrtohet dhe aprovohet nga komiteti ekzekutiv. Atëherë fondet do jenë në dispozicion për komitetet për realizimin e aktiviteteve të parapara në planin i cili është pjesë e buxhetit të projektuar.
- c. Nëse komiteti zhvillon aktivitete të reja gjatë vitit si përgjigje ndaj mundësive të reja ose nevojave të anëtarësisë ose kur aktiviteti tejkalon buxhetin e paraparë, komiteti duhet t'i drejtohet komitetit ekzekutiv për aprovim.
- d. Kjo pavarësi e re financiare duhet të shoqërohet me një sistem raportues i cili siguron shfrytëzimin transparent të mjeteve. OAK duhet ta ndërtojë sistemin e raportimit programor dhe financiar ndërmjet komiteteve dhe komitetit ekzekutiv të OAK-së. OAK do t'i analizoj sistemet të cilat i aplikojnë organizatat tjera dhe do ta ndërtojë sistemin i cili i përmbushë nevojat e OAK-së.
- e. Në kohën kur komiteti e harton planin e vet vjetor të aktiviteteve, ai gjithashtu duhet ta hartojë edhe orarin vjetor të mbledhjeve. Mbledhjet e komiteteve duhet të planifikohen për gjithë vitin për t'ju mundësuar anëtarëve të komitetit planifikimin e duhur dhe për të siguruar se mbledhjet i plotësojnë aktivitetet për t'ju mundësuar komiteteve kohë të mjaftueshme për përgatitjen dhe për raportimin mbi aktivitetet.
- f. OAK duhet gjithashtu të hartojë politikat për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komiteteve. Këto politika duhet të inkurajojnë përkushtimin e anëtarëve (*p.sh.*, secili anëtar i cili mungon në më shumë se tri mbledhje do të shkarkohet nga komiteti) dhe mbrojnë komitetin prej ndërhyrjes nga jashtë (*p.sh.*, kryesuesi i komitetit do të zgjedhet nga komiteti pas një viti shërbim në komitet para zgjedhjes.

(iii) Gjersa komitetet aktivizohen për t'u bërë të pavarura, organe aktive brenda OAK-së, aftësia e OAK-së për ngritjen e fondeve vetëm sa bëhet edhe më e rëndësishme. Ngritja e fondeve përfshinë një sërë aktiviteteve.

- a. Obligimet e anëtarësisë janë çështja e parë dhe më e rëndësishme. OAK do ta përmirësojë grumbullimin e obligimeve të anëtarësisë përmes politikave të cilat përfshijnë sistemin e grumbullimit të obligimeve i cili përbëhet nga afatet e pagesës dhe masat kundër mos pagesës ose për pagesë të vonuar.
- b. OAK do të gjerë edhe alternativat tjera të ngritjes së fondeve, siç janë pagesat për kurset AVL, certifikatat e specializimit, ose materialet

e përmbledhura nga OAK, siç janë doracakët trajnues ose përmbledhjet e ligjeve dhe udhëzimeve.

(iv) Gjersa zhvillohet organizata është me rëndësi të zhvillohen edhe politikat financiare.

- a. OAK duhet të hartojë politika të reja për shpërndarjen e mjeteve, pagimin e rrogave, kompensimin e shpenzimeve, etj.
- b. OAK duhet ta hartojë buxhetin vjetor në fillim të secilit vit duke marr parasysh kontributin nga komitetet dhe nga “degët” në regjione. OAK duhet të zotojë mjete për aktivitetet veta nëse shpreson të bëhet organizatë aktive dhe me ndikim. Buxheti vjetor duhet të përfshijë shpenzimet e parashikuara, fondin e përgjithshëm të të hyrave për shpenzimet e paparashikuara që ndodhin gjatë vitit, si dhe kufirin e kursimeve për projektet afatgjata.
- c. OAK do ta caktojë afatin për propozimet buxhetore nga komitetet e OAK-së dhe “degët” në regjione. Ato do t’i shqyrtojnë këto propozime dhe hartojnë buxhetet e veta vjetore në fillim të secilit vit fiskal. Më pas, komiteti ekzekutiv i OAK-së do ta aprovojë buxhetin vjetor.
- d. Ky sistem do të kërkojë ndërtimin e sistemeve më komplekse financiare. OAK do t’i ndërtojë këto sisteme bazuar në ato që i aplikojnë odat tjera dhe organizatat e avokatëve.
- e. Për implementimin e këtyre sistemeve do të ketë nevojë për trajnimin e drejtuesve të OAK-së (stafit, komitetit ekzekutiv, kryesuesve të komiteteve, drejtuesve rajonalë etj) në çështjet e hartimit të buxheteve, sistemeve financiare dhe kërkesave për raportim.

(v) Këto sisteme të reja mund të kërkojnë numër plotësues të personelit për sigurimin e funksionimit të lehtë të organizatës.

- a. OAK duhet ta vlerësojë nevojën e saj për numër plotësues të personelit në selinë e saj dhe në degët në regjione.
- b. Numri i shtuar i personelit duhet të shoqërohet me zhvillimin e sistemeve të qeverisjes, duke përfshirë përshkrimin e vendeve të punës dhe sistemin e hierarkisë.
- c. Ky personel i ri gjithashtu ka nevojë për t’u trajnuar për sistemin e ri.

## 2.4 Lobimi:

(i) Ishte e qartë nga diskutimi gjatë mbledhjes se OAK dhe anëtarësia e saj ballafaqohet me një numër sfidash të jashtme, të cilat duket se ndikojnë në aftësinë e anëtarëve për ushtrimin e avokaturës dhe rrjedhimisht në mirëqenien dhe jetesën e tyre. Sfidat e jashtme të cilat më së shpeshti i kanë përmendur pjesëmarrësit ishin çështjet e licencimit, sistemit disiplinor, çështjen e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare, përpjekjet e MTI-së për regjistrimin e avokatëve dhe ushtrimi i ligjit nga personat të cilët nuk janë të regjistruar në OAK. Shpeshësia e ngritjes së këtyre çështjeve gjatë mbledhjes demonstroi se sa të fuqishme janë ndjenjat e anëtarëve për këto çështje, por edhe perceptimi i anëtarësisë për seriozitetin që e

manifestojnë këto çështje për OAK-në si një organizatë, veçanërisht nëse nuk merren masa në mënyrë kolektive nga anëtarësia, duke vepruar përmes OAK-së për adresimin e këtyre çështjeve.

- (ii) Gjatë mbledhjes është pranuar përgjithësisht se mënyra e duhur për trajtimin e këtyre çështjeve është që OAK të llojë tek palët tjera të interesuara në sistemin juridik, siç janë, qeveria, ministrat individual dhe ministritë dhe ligjvënësit. Ndikimi kësaj në aspektin strategjik është se OAK duhet të fokusohet në angazhimet e veta lobuese në mënyrë që lobimi të bëhet cak dhe funksion themelor i OAK-së. Nga diskutimet ishte evidente se OAK do të ketë nevojë t'ia demonstrojë anëtarësisë së vet se është në kontakt me ta dhe se i ka synimet e përbashkëta me ta. Kjo nënkupton se OAK ka nevojë të mbajë dialog të vazhdueshëm me anëtarësinë e vet në raport me çështjet e jashtme me të cilat ballafaqohen anëtarët e vet gjatë praktikës së tyre të përditshme.
- (iii) Duke u mbështetur në këtë, OAK ka nevojë të shihet nga anëtarësia se është duke lobuar aktivisht tek palët tjera me interes në sistemin juridik, për të vepruar ndaj çështjeve të identifikuara nga anëtarësia. Gjatë mbledhjes është pranuar se si një pikënisje e mirë për lobim do të ishte që një komiteti të OAK-së t'i caktohej detyra e lobimit. Ka pasur diskutim edhe për strukturën e komiteteve të OAK-së në përgjithësi dhe është arritur pajtimi i përgjithshëm (përkritazi me lobimin dhe caqet tjera) se gjersa ekziston një strukturë e gjerë e komiteteve të cilat mund të jenë të afta të merren me caqet e identifikuara, do të ishte shumë efikase, aty ku është e përshtatshme, të shfrytëzohet komiteti ekzistues për t'u marrë me lobim (dhe caqet tjera) për të evituar shumimin e komiteteve brenda OAK-së.
- (iii) Gjatë mbledhjes ka ekzistuar një përshtypje se puna lobuese në këto çështje të jashtme është bërë çështje e besimit të anëtarësisë në vetë OAK-në.
- (iv) Detyra specifike për përparimin e këtij caku janë listuar në faqet pasuese të kornizës tabelare nga orari A .

## 2.5 Disiplina dhe Etika:

- (i) Gjatë rrjedhës së mbledhjes është zhvilluar mjaft diskutim lidhur me disiplinën dhe etikën. Nga diskutimi është parë se kjo është një nga fushat ku OAK vetëm ka bërë përparim të dukshëm gjatë disa viteve të kaluara, që dëshmohet nga fakti se OAK tani e ka vendosur sistemin e ri disiplinor dhe Kodin e Etikës. Ky përparim është njohur edhe nga pjesëmarrësit e mbledhjes.
- (ii) Çështjet e disiplinës dhe etikës mund të shihen si attribute të OAK-së e të cilat nga OAK-ja do të mund të potencoheshin gjatë marketingut të

përfitimeve të shfrytëzimit të avokatëve të OAK-së për shfrytëzuesit e shërbimeve juridike. Ekzistimi i Kodit të Etikës, i cili mbështetet nga një sistem funksionues dhe i besueshëm disiplinor, është një përparësi e konsiderueshme për shfrytëzimin e avokatëve të OAK-së dhe veçoritë dalluese të avokatëve të OAK-së dhe ofruesve tjerë të parregulluar dhe *ad-hoc* të shërbimeve juridike. Është e rëndësishme dhe e përshtatshme për OAK-në që të reklamojë për shfrytëzuesit e shërbimeve juridike, në emër të anëtarëve të saj, faktin se përdorimi i avokatit të OAK-së sjellë me vete anën pozitive se avokati i OAK-së i nënshtrohet rregullave të Kodit të Etikës dhe sistemit përkatës disiplinor, në të cilat mund të thirret shfrytëzuesi i shërbimeve juridike në rast se avokati në fjalë i OAK-së nuk sillet si duhet.

- (iii) Për arritjen e potencialit të tij të plotë të mbrojtjes së publikut dhe avokatëve tjerë nga veprimet jo etike dhe për promovimin e besimit të publikut në aftësitë dhe profesionalizmin e të gjithë avokatëve, sistemi i tanishëm disiplinor duhet të reformohet në mënyrë që të bëhet më efikas dhe më transparent. Hapat si në vijim do ta shpijnë OAK-në drejt caktit të dyfishtë të efikasitetit dhe transparencës:
- a. Komiteti për etikë duhet t'i takojë dhe anëtarëve të caktuar t'u caktojë detyrat për rekomandimin e ndryshimeve të Kodit të Etikës, procesit disiplinor të OAK-së dhe strukturës së komitetit disiplinor të OAK-së për qëllim të bërjes së procesit ankimor dhe disiplinor sa më efikas dhe transparent. Komiteti duhet të merr parasysh se a do t'i zbatojë dhe si do t'i zbatojë së paku këto reforma:
    - i. Konsolidimin në një komplet rregullash, të rregullave të komiteteve të ndryshme të OAK-së të cilat e përbëjnë sistemin disiplinor.
    - ii. Zhvillimin e udhëzimeve dhe rregullave për publikimin e vendimeve nga sistemin disiplinor me synimin e publikimit të të gjitha atyre vendime. Krijimin e hapësirës zyrtare për këto publikime, *p.sh.*, ueb-faqja e OAK-së.
    - iii. Theksimin dhe nxitjen e zgjidhjes së ankesave disiplinore kundër avokatëve mbi bazën materiale dhe jo procedurale. Fuqishëm dekurajon zgjidhjen e ankesave mbi bazën e parashkrimit, veçanërisht deri sa anëtarët e publikut të informohen plotësisht dhe të mësojnë për të drejtën e ankimit ndaj avokatëve të tyre.
    - iv. Të bëhen publike të gjitha procedurat disiplinore ndaj avokatëve përveç kur interesi i drejtësisë kërkon ndryshe.
    - v. Të bëhet e ditur gjerësisht se shqyrtimi gjyqësor i vendimeve disiplinore është i mundur pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.
    - vi. Të krijohet procesi formal i zgjidhjes së ankesave për shkelje të lehta me masa tjera nga ato të sanksionimit ose shkarkimit, në mënyrë që të ekzistojë opsioni për t'i trajtuar ato çështje në mënyrë më të përshtatshme përmes mjeteve edukative ose mjekësore (fizike ose psikologjike).



- vii. Të shpik një metodë dhe mënyrë për raportimin vjetor para anëtarësisë së OAK-së dhe publikut lidhur me gjendjen e sistemit disiplinor të avokatit kosovar dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.
  - viii. Të sigurohet që rregullat procedurale dhe të administrimit të provave të zbatueshme në përgjithësi në procedurë administrative, të zbatosh në të gjitha procedurat disiplinore ndaj avokatëve dhe që prokurori të ketë detyrë t'i dëshmojë pohimet nga kërkesa për masën disiplinore duke u bazuar në dëshmitë bindëse.
  - ix. Të organizohen trajnime vjetore për të gjithë stafin e OAK-së lidhur me procesin disiplinor për aq sa është e mundur maksimalisht të hapen ato trajnime edhe për zyrtarët gjyqësor dhe anëtarët e interesuar të OAK-së.
  - x. Të merren parasysh rekomandimet tjera nga vlerësimi i profesor B. Powell mbi odën autoritative (rregullative).
- b. Bordi ekzekutiv i OAK-së duhet t'i caktojë detyrë komitetit të caktuar ose vetë t'i rregullojë këto çështje:
- i. Të krijojë një vijë buxhetore specifike dhe të pavarur për etikën dhe çështjet disiplinore.
  - ii. Të hartohet plani dhe orari kohor për sigurimin e hapësirës së veçantë ose zyrës për shfrytëzim nga stafi dhe komitetet të cilat janë pjesë e sistemit disiplinor.
  - iii. Të merr parasysh mundësinë e sigurimit të së paku një këshilltari me pagesë për qëllimet e sistemit disiplinor.
- c. Komiteti për etikë dhe/ose komitetit për AVL duhet të hartojnë planin për mbikëqyrjen e vazhdueshme të trajnimit të avokatëve dhe *praktikantëve* në etikë, duke përfshirë zhvillimin në vazhdim e sipër të trajnimeve mbi Kodin e Etikës, shkeljet dhe sanksionet, si në vijim:
- i. Të përcaktohet minimumi i arsimimit të vazhdueshëm ligjor mbi etikën dhe kjo të bëhet e obligueshme.
  - ii. Të zhvillohen trajnime plotësuese për avokatët dhe *praktikantët* mbi aspektet e ndryshme të Kodit të Etikës, duke përfshirë sjelljen e avokatëve, standardet e kujdesit ndaj klientit dhe të ngjashme.

## 2.6 Ekselencë Ligjore:

- (i) Koncepti i ekselencës ligjore është përdorur si shenjë (etiketë) për një varg temash të ndërlidhura që buruan nga diskutimet e zhvilluara gjatë mbledhjes. Ishte përdorur për të përmbledhur në një pikë faktorët dallues midis personave të cilët janë anëtarë të organit të rregulluar dhe profesional – i cili ofron shërbime juridike për anëtarët e publikut – karshi personave që nuk janë anëtarë të organit profesional ligjor dhe si të tillë nuk i nënshtrohen standardeve të ngjashme mbi kualifikimet arsimore të

tyre dhe nga aspekti i arsimimit në ecje e sipër, rregullimit dhe disiplinës rigoroze për anëtarësinë e organit ligjor profesional.

- (ii) Për OAK-në ky diferencim ka rëndësi të veçantë duke pasur parasysh se anëtarët e OAK-së janë të vetëdijshëm se ata që nuk janë anëtarë të OAK-së ofrojnë shërbime juridike për publikun e Kosovës (kjo është çështja kryesore e identifikuar në kontekst të aktiviteteve lobuese të OAK-së). Kjo çështje për anëtarët e OAK-së është çështje e mbijetesës ngase ndërhyr në veprimtarinë të cilën duhet ta zhvillojnë anëtarët e OAK-së. Përveç kësaj, ekziston edhe çështja e varur nga ajo, e që është cilësia e shërbimeve të dhëna nga ata që nuk janë anëtarë të OAK-së, perceptohet gjerësisht si e kualitetit të dobët dhe si e tillë mund të ndikojë negativisht në profesionin ligjor në tërësi. Diskutimi mbi këto tema mund të reduktohet në idenë se OAK duhet ofrojë cilësi superiore për shfrytëzuesit e shërbimeve juridike, si në aspektin real ashtu edhe në aspektin e perceptimit të shfrytëzuesve.
- (iii) Rrjedhimisht, ideja ishte që nën një titull të vendoseshin përbërës të ndryshëm që dolën nga diskutimi, në mënyrë që OAK të ketë mundësi ta zhvillojë një qasje të fokusuar për ngritjen e standardit në radhët e anëtarësisë së vet dhe krahas kësaj, vetë anëtarësia do të bëhej më e ndërgjegjshme për rëndësinë e ruajtjes së standardeve të larta.
- (iv) Është pranuar gjithashtu se një nga përfitimet kyçe nga të qenit anëtarë i OAK-së duhet të ishte njohja e qartë nga shfrytëzuesit e shërbimeve juridike se anëtarët e OAK-së gjithmonë e përfaqësojnë një ofertë të cilësisë të lartë krahasuar me ata që nuk janë anëtarë. Nëse shfrytëzuesit e shërbimeve juridike nuk e shohin në këtë mënyrë këtë diferencë midis anëtarëve të OAK-së dhe të tjerëve, atëherë anëtarësia e OAK-së duhet të fokusohet në artikullimin e cilësisë së shërbimeve nga anëtarësia për shfrytëzuesit e shërbimeve juridike, në mënyrë që këta të fundit do të përcaktohen gjithmonë për anëtarët e OAK-së dhe jo për ata që nuk janë anëtarë dhe atë për shkak të cilësisë. Shembulli i ofertës cilësore, nga një juridiksion tjetër që ishte përmendur gjatë mbledhjes, ishte se në disa juridiksione tjera, ku ushtrimi i avokaturës në disa fusha nuk ishte i ndaluar për personat jo-profesionistë, shfrytëzuesit e shërbimeve juridike megjithatë zgjidhnin jashtëzakonisht më shumë anëtarët e organizatës profesionale për shkak të cilësisë superiore të shërbimeve që i ofronin si dhe komfortit të ofruar nga regjimi rigoroz rregullativ.
- (v) Janë identifikuar pesë “damarët” kryesorë si pjesë e angazhimit të OAK-së për realizimin e cakut të ngritjes së shkallës së “ekselencës ligjore”: (1) trajnimi/arsimimi i praktikantëve; (2) arsimimi i vazhdueshëm ligjor (AVL); (3) diploma për temat e specializuara; (4) promovimi i standardeve më të larta në radhët e anëtarëve të profesionit; dhe (5) ngritja e standardeve për regjistrim në OAK. Siç mund të shihet, theks i veçantë i është dhënë standardeve edukative në përgjithësi. Ky është një ofertë për cilësi. Aspekti i ekselencës ligjore të OAK-së ka shtuar nga pesha edhe

përmes funksioneve disiplinore dhe të etikës të OAK-së (*p.sh.,m* funksioni rregullativ – i rregullatorit), edhe pse kjo është atëherë kur dështon ekselencia ligjore dhe kështu trajtohet e ndarë në këtë dokument.

- (vi) Një numër pjesëmarrësish në mbledhje i kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me standardin e përgjithshëm të edukimit të avokatëve dhe nivelin e përgatitjes së avokatëve për kryerjen e detyrave. Fryma e përgjithshme e këtyre diskutimeve ishte se OAK duhet të jetë vigjilente për ruajtjen e standardeve dhe cilësisë së anëtarësisë së vet, si nga aspekti i standardeve të hyrjes në profesion ashtu edhe më vonë gjatë karrierës si avokatë.
- (vii) Pjesëmarrësit e mbledhjes kanë shprehur gjithashtu shqetësimet e tyre lidhur me atë se OAK nuk ishte më rigorozë në përcaktimin parametrave të ekselencës së anëtarësisë së vet dhe në imponimin e ekselencës së anëtarëve të vet. Dështimi i një pjese të OAK-së të bëjë kështu, ishte parë si prishje potenciale e imazhit të OAK-së dhe përfitimeve të perceptuara nga publiku për shfrytëzimin e avokatit të OAK-së që në anën tjetër do t'i zvogëlonte gjasat që anëtarët e publikut dhe të tjerët të shfrytëzojnë avokatët e OAK-së karshi të tjerëve që nuk janë anëtarë.
- (viii) Përfundimisht, ekselencia ligjore është thelbi i të siguarit të prosperitetit të OAK-së në të ardhmen, ngase fakti se OAK përfaqon dhe identifikohet me ekselencën, përfundimisht duhet të përfaqësojë argumentin shtytës ekonomik që i nxitë shfrytëzuesit e shërbimeve juridike për angazhimin e përhershëm të anëtarëve të OAK-së. Por ekselencia ligjore nuk duhet të trajtohet si e izoluar (siç është rasti me të gjitha funksionet e OAK-së të diskutuar në këtë dokument). Në këtë drejtim, angazhimet/aftësitë lobuese dhe avokuese duhet të shfrytëzohen gjithandej nga OAK-ja në mënyrë që ta përcjellë mesazhin e cilësisë tek publiku. Krahas kësaj, është qenësore që atëherë kur ekselencia ligjore dështon, që anëtarët e publikut të kenë besimin se ata do të mund të përgjigjen para aspektit disiplinor dhe etik të OAK-së, ashtu që ankesat të shqyrtohen në mënyrë efikase, të drejtë dhe transparente.

## 2.7 Zhvillimi dhe Shërbimet e Anëtarësisë të OAK-së:

- (i) Sipas Ligjit mbi ndihmën juridike (në pritje të aprovimit), OAK është “organizatë e lirë dhe e pavarur anëtarët e të cilës do të kenë autoritetin ekskluziv të ushtrimit të ligjit. (kreu I, neni I, paragrafi 1.1; kreu II, neni II, paragrafi 2.2.). Aspektet kryesore të misionit të saj janë: (1) t'i regjistrojë avokatët në pajtim me ligjit; (2) ofrojë shërbime të drejtpërdrejta për anëtarët e vet, të cilat i rrisin aftësitë e tyre për ushtrimin e ligjit në shkallën më të lartë të profesionalizmit; (3) sigurimi se të gjitha pjesët e shoqërisë, veçanërisht pakicat dhe gratë, të kenë mundësinë e pjesëmarrjes së plotë në ushtrimin e ligjit; dhe (4) të shërbejë si drejtues për dhënësit e pa licencuar të shërbimeve juridike (juristët, notarët, dhe përfaqësuesit me prokurë), për ata që janë në trajnim për dhënie e

shërbimeve juridike (*praktikantët* dhe studentët e drejtësisë) dhe ata që ofrojnë shërbime vartëse për profesionin ligjor (p.sh., profesorët e drejtësisë).

(ii) Gjatë mbledhjes, komentet lidhur me këtë temë strategjike kryesisht kishin të bënin me organizimin dhe komunikimin më të mirë të OAK-së me anëtarësinë e saj, duke përfshirë këtu edhe organizatat e regjioneve. Komentet gjithashtu fokusoheshin në atë që punët e brendshme të OAK-së të bëheshin më transparente për anëtarësinë dhe mund të përmbledheshin në idenë për dhënien e të drejtës së votës anëtarësisë së OAK-së. Krahas kësaj, anketa me anëtarësinë e zhvilluar para mbledhjes ka vënë në pah se një numër i rëndësishëm i anëtarëve të OAK-së besojnë se rëndësi të madhe do të kishin këto synime: anëtarëve t’ju jepet mundësi të takohen dhe të ndër-veprojnë me avokatët lokal dhe profesionistët tjerë ligjore, lehtësimi i mundësive për zhvillimin e biznesit, dhënia e shërbimeve që u ndihmojnë avokatëve në praktikën e tyre, dhe rekrutimi dhe ngritja e numrit të avokatëve femra dhe nga pakicat. Për arritjen e këtyre synimeve për zhvillimin e shërbimeve të anëtarësisë, hapat si në vijim do të mund të merreshin:

a. Formimi i komitetit për anëtarësinë, anëtarët e të cilëve janë së paku kryetarët e organizatave të regjioneve, dhe që ky komitet të ketë këto detyra:

1. të hartojë dhe zbatojë programin e mbledhjeve të rregullta për secilën nga organizatat e regjioneve.

i. Nga modelet për mbledhjet e rregullta, komiteti do të mund të merrte parasysh takimet mujore gjatë ngrënies së mëngjesit, drekës ose darkës në datat e njëjta të secilit muaj të radhës, në restorantet lokale të regjioneve, të paguara nga vetë pjesëmarrësit, në të cilat do të shkëmbeheshin informatat lidhur me aktivitetet dhe çështjet e OAK-së, ku do të zhvilloheshin bizneset e mundshme dhe ofroheshin programe të shkurta të AVL-së dhe bashkëpunim me komitetin e AVL-së.

ii. Komiteti për anëtarësi duhet të ketë parasysh se mbledhjet e rregullta regjionale duhet t’i arrijnë synimet e: (1) ngritjes së shkallës së komunikimit midis drejtuesve të OAK-së dhe anëtarëve të saj; (2) ofrimit të mundësive për profesionistët ligjor të vendit që të takohen dhe të ndër-veprojnë; dhe (3) ofrimin e trajnimeve aftësuese dhe ideve për ngritjen e biznesit përmes programeve të përshtatshme të AVL-së.

2. Të shqyrtojë dhe të jep rekomandime për reformat e bordit ekzekutiv të OAK-së për anëtarësinë e OAK-së, kushtet, strukturën dhe obligimet. Komiteti në veçanti duhet shqyrtojë:

i. Pagesë më të ulët të anëtarësisë për avokatët femra dhe nga pakicat për ta rritur numrin e tyre në profesion;

ii. Ndryshimin e procedurës së regjistrimit ashtu që avokatët të mund të regjistrohen në OAK edhe në regjionet tjera

përveç Prishtinës. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për lehtësimin e regjistrimit të avokatëve nga pakicat;

iii. Mundësinë e krijimi të kategorive të anëtarësisë pa të drejtë vote të profesionistëve ligjor, të tjerë nga avokatët, duke përfshirë juristët, profesorët e drejtësisë, studentët e drejtësisë, prokurorët dhe gjykatësit. Kjo do të arrinte synimin e: (1) ofrimit të mundësive nëpër mbledhjet regjionale për të gjithë profesionistët ligjor që të takohen dhe ndër-veprojnë me qëllim të përmirësimit të kolegjalitetit; (2) zgjerimit të bazës së obligimeve (të ardhurave nga anëtarësia) të OAK-së; (3) ofrimit të mundësive për ngritjen e imazhit dhe standardeve të profesionit ligjor në përgjithësi.

3. Të krijojë dhe zbatojë procesin e lidhjes së “kontratave ekskluzive me përfitim të anëtarëve” me shitësit, tregtarët dhe profesionistëve tjerë që ofrojnë produkte dhe shërbime të cilat anëtarët e OAK-së i shfrytëzojnë rregullisht. Sipas këtyre programeve, ofruesi i produktit ose shërbimeve do të pajtohej të ofrojë lirim për produktin ose shërbimet e veta secilit anëtar të OAK-së, dhe OAK si kundër shpërblim do t’i ofronte ofruesit të shërbimeve ose produktit të drejtën ekskluzive të reklamimit në anëtarësinë e OAK-së. Qasja ekskluzive e reklamimit do të përfshinte, për shembull, të drejtën e reklamimit në ueb-faqen e OAK-së, qasjen në adresat afariste të të gjithë anëtarëve të OAK-së, të drejtën e pjesëmarrjes në funksionet shoqërore të OAK-së, të drejtën e reklamimit gjatë mbledhjeve të rregullta të OAK-së.
4. Të gurmtojë rifillimin e mbledhjeve vjetore ose kuvendeve për të gjithë anëtarët e OAK-së

b. T’i jepet detyrë komitetit për gjini dhe pakica ose komitetit tjetër lidhur me:

1. Shqyrtimin e mundësisë të ndarjes së komitetit ekzistues në dy nën-komite.
2. Punën me komitetin për anëtarësi të evokojë dhe rekomandojë:
  - i. Çmim të ulur të anëtarësisë për avokatët nga pakicat dhe avokatet femra me qëllim të ngritjes së numrit të tyre në profesion; dhe
  - ii. Ndryshimin e procedurës së regjistrimit ashtu që avokatët të regjistrohen në OAK në regjionet tjera përveç Prishtinës. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për lehtësimin e regjistrimit të avokatëve nga pakicat;
3. Të vazhdojë implementimin e garës vjetore për esenë më të mirë që ofron bursa për studentët e drejtësisë nga radhët e pakicave dhe atyre femra që shkruajnë mbi temat që kanë të bëjnë me gruan, pakicat dhe drejtësinë.

4. Të punojë me ABA ROLI-n për krijimin e programit mentorues midis avokatëve të OAK-së dhe studentëve të drejtësisë nga pakicat dhe ato femra.
  5. Të punojë me ABA ROLI-n për hulumtimin e programeve të cilat lehtësojnë femrave dhe avokatëve nga pakicat të hapin avokaturat.
  6. Të hulumtojë me ABA ROLI-n për rrugët për krijimin e rrjeteve me gratë nga aspektet tjerat të profesionit ligjor, *p.sh.*, gjykatësit, prokurorët, profesorët e drejtësisë, studentë dhe juristët.
  7. Të punojë me komitetin për anëtarësi që të sigurojë mundësitë për aktivitet e odave lokale të cilat përfshijnë pakicat.
- c. Të institucionalizohet publikimi i rregullt dhe azhurnimi i publikimeve të OAK-së duke:
1. emëruar një redaktor ose ekip të vogël redaktues për mbikëqyrjen e buletinit, të krijojë dhe zbatojë orarin e publikimit të rregullt.
  2. emëruar një redaktor ose ekip të vogël redaktues për mbikëqyrjen e “Avokatura”, të krijojë dhe zbatojë orarin e publikimit të rregullt.
  3. i dhënë detyrë një personi ose ekipi të vogël për ta mbikëqyrë azhurnimin e vazhdueshëm, të rregullt të përmbajtjes së ueb-faqes së OAK-së.

### 3. **Mbledhja - Metodologjia**

Mbledhjen e ka formësuar dhe organizuar Shoqatat e avokatëve amerikanë. Aty kanë marrë pjesë deri në 25 anëtarë të OAK-së dhe pjesëmarrësit ishin vendosur në tryezë të rrumbullakët për dialog, që përfshinte seanca plenare dhe ndarje në grupe të vogla përgjatë tre ditëve. Mbledhja ishte lehtësuar nga dy ndërmjetësues të jashtëm nga Shoqata e avokatëve irlandezë të cilët i ka caktuar ABA dhe të cilët ishin ndihmuar nga personeli i ABA gjatë mbledhjes.

### 4. **Misioni i OAK-së**

- 4.1 Si një ushtrim paraprak gjatë mbledhjes, me qëllim të nxitjes së mendimeve të pjesëmarrësve lidhur me OAK-në, se kujt i shërben dhe në ç’drejtim po shkon, pjesëmarrësit e kaluan sesionin e parë duke shqyrtuar draftin e deklaratës së misionit të OAK-së. Draft deklarata mbi misionin ishte hartuar gjatë punëtorisë para-planifikuese. Qëllimi i ekzaminimit të deklaratës së misionit të OAK-së ishte të pasqyrojë faktin se, gjersa planifikimi strategjik është një proces dinamik dhe si i tillë në gjendje gjithnjë të lëvizshme dhe duke evoluar, deklarata e misionit duhet të mbetet konstante gjatë gjithë ekzistencës së OAK-së. Në të vërtetë, deklarata e misionit është standard për OAK-në dhe rrjedhimisht kjo deklaratë duhet të përmbledhë të gjithë atë që është konstante dhe e qenësishme për OAK-në, pa marrë parasysh kalimin kohës dhe paraqitjen e sfidave të reja.



## 5. Vizioni i OAK-së

- 5.1 Në pjesën më të madhe të paradites së dytë të mbledhjes, pjesëmarrësit ishin angazhuar në diskutimet lidhur me vizionin e OAK-së për ët ardhmen. Ky diskutim vazhdoi me ndarjen e pjesëmarrësve të mbledhjes në katër grupe, ku secili grup përbëhej nga avokatë me përvojë dhe papërvojë. Këto ishin katër grupet: grupi i ruajtjes, eliminimit, evitimit (shmangies) dhe arritjes. Qëllimi i ndarjes në grupe ishte të lehtësohet diskutimi mbi vizionin e OAK-së se kah duhet të shkojë në të ardhmen.
- 5.2 Diskutimet mbi vizionin e paraqisnin fillimin e procesit distilues, qëllimi i të cilit ishte të merren çështjet e veçanta dhe temat që kishin dalë nga diskutimet e pjesëmarrësve dhe pastrimi (filtrimi) i atyre temave të gjera në grupet përkatëse që do të shqyrtoheshin në segmentin e përcaktimit të caqeve gjatë pasdites në ditën e dytë të mbledhjes. Nga diskutimet përkitazi me vizionin, kanë dalë pesë tema kryesore si këto në vijim: (i) Administrata e OAK-së (ii) Funkzioni i përmirësuar i lobimit/avokimit, shqyrtimit të legjislacionit; (iii) Disiplina dhe etika; (iv) Ekselencia ligjore dhe (v) Zhvillimi i shërbimeve për anëtarësinë e OAK-së.

## 6. Caqet dhe Prioritetet e OAK-së

Në ditën e dytë – pasdite, pjesëmarrësit e mbledhjes ishin angazhuar në diskutimet lidhur me pesë temat kryesore të OAK-së për diskutim. Këto tema të rëndësishme ishin identifikuar gjatë sesionit të hershëm të po të njëjtës ditë. Identifikimi i caqeve ka paraqitur nevojën e filtrimit të mëtutjeshëm të temave me qëllim që OAK të mund të identifikojë objektivat specifike. Objektivat më pas duhej të radhiteshin sipas prioritetit për shkak të kufizimeve kohore, njerëzore dhe të burimeve financiare për arritjen e njëkohshme të gjitha këtyre caqeve. Prapë, ky segment i diskutimit ka përfshirë ndarjen e pjesëmarrësve të mbledhjes në grupe të cilat përbëheshin nga avokat me përvojë dhe nga ata të papërvojë. Secili grup e mori një temë – cak për ta diskutuar. Rezultatet e këtij diskutimi përfaqësojnë objektivat e planit strategjik, të cilët paraqiten në hollësi në kornizën tabelare të orarit A të këtij dokumenti.

## 7. Zbatimi i Planit Strategjik

- 7.1 Njëherë pasi të caktohen caqet dhe strategjia, ato duhet të zbatohen përndryshe shumë pak mund të ketë dobi nga planifikimit. Përfundimisht, aftësia e OAK-së për implementimin e strategjisë së saj dhe arritjes së caqeve të veta është çështje në duart e OAK-së. Pjesëmarrja në mbledhjen për planifikim strategjik dhe përfundimi i këtij dokumenti janë të dobishme dhe aktivitete të nevojshme, e të cilat janë pjesë integrale e procesit të planifikimit strategjik. Procesi i planifikimit strategjik është i paraparë të nxjerrë në pah dhe t'i jep formë objektive dhe caqeve në mënyrë strukturore, në mënyrë që t'i mundësojë organizatës të ecë përpara në mënyrë të përqendruar në punën e implementimit të caqeve të saj. Mirëpo, caqet tanimë ekzistuese edhe pse të shpërndara në radhët e anëtarësisë

- kolektive të OAK-së. Përndryshe, procesi i planifikimit strategjik i radhitjes së ideve dhe komenteve të anëtarësisë së OAK-së, dhe pastaj grupimi i këtyre ideve nëpër temat dhe caqe, dhe vënia e tyre në formatin e përshtatshëm, *p.sh.*, ky dokument.
- 7.2 Në këtë drejtim procesi i planifikimit duhet të shihet si punë e varur nga puna kryesore, e cila fillon pas procesit të planifikimit dhe pasi të jetë kryer ky dokument. Atëherë, organizata është ajo e cila ballafaqohet me realitetin e angazhimit në implementimin e strategjisë së vet përmes veprimeve të fokusuara dhe përbashkëta. OAK si e tillë do të ketë nevojë të investojë kohë, energji dhe mbi të gjitha, durim në punën e implementimit. Krahas kësaj, të gjitha këto nevoja duhet të bëhen duke pasur parasysh analizën e vazhdueshme, e cila përfshinë rishqyrtimin e vazhdueshëm të asaj se çka paraqet OAK-ja, kujt i shërben, dhe cilat kërcënime dhe mundësi të reja janë shfaqur ose cilat kanë për t'u shfaqur.
- 7.3 Përpjekjet e dyfishta për implementim dhe analizim janë barrë e rëndë për cilëndo organizatë, drejtues të saj dhe anëtarësi, por është barrë kolektive që duhet të bartet nga e gjithë anëtarësia. Këtu ndërlihet fakti që progresi (ose mungesa e tij) ka nevojë të vlerësohet objektivisht nga kuptimi i rrethanave të ndryshuara dhe koha dhe angazhimi i bërë nga anëtarësia për implementim. Dështimi ose suksesi i planit strategjik është përgjegjësi e të gjithë anëtarësisë dhe nuk duhet të lejohet të shndërrohet në instrument i interesave për arritjen e agjendave të tyre personale.
- 7.4 Ashtu sikur në pjesën 6, si më lart, caqet janë paraqitur në orarin A të këtij dokumenti. Korniza tabelare është një mjet ndihmës për caktimin e prioriteteve dhe implementimin e caqeve dhe si e tillë e ndanë secilin cak veç e veç në nën-caqe (*pikët strategjike/të veprimit*), hapa të ardhshëm, personat përgjegjës, afatin kohor për raportimin e progresit dhe prioritetin e caktimit (ose nën-caktimit). Korniza kohore gjithashtu përcakton indikatorët e rezultateve duke matur shkallën e zbatimit. Faqet në vijim të këtij dokumenti përbëjnë kornizën tabelare dhe kalendarët vjetor për komitetet kryesore të OAK-së.

## **ORARI A – ANALIZA E KORNIZËS TABELARE**

**Rezultati Strategjik 1: Administrata e Përmirësuar e OAK-së**

**Grupi Punues: TP (të përcaktohet)**

**Definicioni i Suksesit:**

**TP (të përcaktohet) nga Bordi Ekzekutiv. Për shembull:**

- Ndryshimi i politikave të brendshme të OAK-së për plotësimin e nevojave të OAK-së aktive
- Degët regjionale aktive me marrëdhënie të definnuar qartë me selinë (kombëtare)
- Komitete aktive me një shkallë të autonomisë e cila mundëson veprim të shpejtë për shfrytëzimin e mundësive të reja
- Plani i ngritjes së fondeve i cili korrespondon me buxhetin vjetor të OAK-së
- Sistemi transparent i raportimit financiar dhe programor për degët e regjionit, komitetet dhe selinë.

<b>Pikët strategjike/të veprimit</b>	<b>Hapi i ardhëm</b>	<b>Përgjegjësia</b>	<b>Afati kohor/statusi</b>	<b>Prioriteti/buxheti</b>
1. T'i jepet detyrë komitetit për reformimin e administratës së OAK-së	(i) Konsultimi me bordin ekzekutiv, ABA-n dhe organizatat tjera (ii) Zhvillimi i politikave të reja të shkruara lidhur me administratën dhe organet e OAK-së (iii) Përgatitja e propozimeve, pastaj dorëzimi i tyre para bordit ekzekutiv dhe	Bordi ekzekutiv	Shkurt 2009 Mars 2009 Mars-qershor 2009	Prioritet i lartë Të financohet nga buxheti i gëndrueshëm

	<p>kuvendit nëse paraqitet nevoja</p> <p>(iv) Themelimi i strukturave regjionale</p> <p>(v) Sigurimi i objekteve dhe pajisjeve në regjione</p> <p>(vi) Përzgjedhja e personelit të administratës për regjione</p> <p>(vii) Konkursset për punë në regjione, intervistat, kandidatët e rrethit të ngushtë dhe nënshkrimi i kontratave</p>		<p>Dhjetor 2010</p> <p>Dhjetor 2010</p> <p>Dhjetor 2010</p> <p>Dhjetor 2010</p>	
2. Zhvillimi i komiteve	<p>(i) Secili komitet përfaqësohet në komitetin ekzekutiv</p> <p>(ii) Komitetet zhvillojnë planin vjetor për aktivitete dhe buxhet në fillim të secilit vit</p>	Bordi Ekzekutiv dhe komitetet	<p>Qershor 2009</p> <p>Vjetore fillimi (janar), 2010</p>	Prioritet i lartë

	<p>(iii) Hapja e pozitive për komitete (kryesues, sekretari, etj)</p> <p>(iv) Krijimi i sistemit të raportimit (programatik dhe financiar) para komitetit ekzekutiv</p> <p>(v) Përpilimi i orarit vjetor të mbledhjeve (orari i takimeve bëhet publik)</p> <p>(vi) Hartimi i politikave për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të komiteteve</p> <p>(vii) Krijimi i komitetit për ngritjen e fondeve</p>		<p>Qershor 2009</p> <p>Mars 2010</p> <p>Vjetore (mars), fillimi 2010</p> <p>Qershor 2009</p> <p>Mars 2009</p>	
3. T'i jepet detyrë komitetit të ngritë fondet	(i) Përmirësimi i mbledhjes së obligimeve të anëtarësisë përmes politikave mbi pagesën e anëtarësisë, masat kundër mos pagesës, sistemin e mbledhjes së pagesës.	Komiteti për ngritje të fondeve	Mars 2009 (të shqyrtohet në çdo shtator)	Prioriteti i lartë



	(ii) Hulumtimi i mundësive alternative të ngritjes së fondeve siç janë pagesat për kurset e AVL-së, teste dhe/ose pagesa të kurseve për certifikata të specializuara.		Shtator 2009	
4. Financat/Buxheti	<p>(i) Hartimi i politikave financiare për shpërndarjen e fondeve, rrogave, shpenzimeve afariste, etj.</p> <p>(ii) Përcaktohet orari/afatet për propozimet për buxhetin vjetor për organet e OAK-së</p> <p>(iii) Krijimi i buxhetit në fillim të secilit vit me kontributet nga komitetet dhe degët nga regjioni</p> <p>(iv) Komiteti ekzekutiv aprovon buxhetin për secilin organ (degët</p>	Bordi ekzekutiv	<p>Shtator 2009</p> <p>Qershor 2009</p> <p>Vjetore (shkurt), Fillimi 2010</p> <p>Vjetore (shkurt), Fillimi 2010</p>	Prioritet i lartë

	<p>regjionale dhe komitetet)</p> <p>(v) Sistemi i raportimit financiar (mujor/tre-mujor)</p> <p>(vi) Krijimi i sistemit për fonde diskrecionale</p> <p>(vii) Krijimi i sistemit për organet të kërkojnë fonde shtesë.</p> <p>(viii) Trajnim mbi raportimin për komitetet dhe degët regjionale.</p>		<p>Mars 2010</p> <p>Qershor 2009</p> <p>Qershor 2009</p> <p>Shtator 2009</p>	
5. Personeli	<p>(i) Përcaktimi i nevojave për personel për selinë dhe degët regjionale</p> <p>(ii) Krijimi i hierarkisë, sistemi i mbikëqyrjes, përshkrimet e vendit të punës, etj.</p> <p>(iii) Ofrimi i trajnimit për personelin e paguar dhe vullnetar.</p>	Bordi ekzekutiv dhe resurset njerëzore	<p>Qershor 2009</p> <p>Qershor 2009</p> <p>Janar 2010</p>	Prioritet i lartë

**Rezultati Strategjik 2:** I përmirësuar funksioni i lobimit/avokimit/shqyrtimit të legjislativitetit

**Grupi Punues:** [Komiteti për çështje legjislative]

**Definicioni i Suksesit:** TP (të përcaktohet). Për shembull:

- Mbledhjet e para të përfaqësuesve të OAK-së me Këshillin gjyqësor të Kosovës, ministrin e Drejtësisë, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Kuvendin e Kosovës dhe komisionet e tija, kryeministrin dhe/ose grupet tjera të identifikuar nga OAK si esenciale për synimet e saj lobuese për iniciimin e diskutimeve mbi çështjet lobuese të OAK-së.
- Takimet e rregullta me KGJK-në, ministrin e Drejtësisë (ose një zyrtar i lartë i Ministrisë të Drejtësisë) dhe përfaqësuesit e duhur të Kuvendit të Kosovës, kryeministrin dhe/ose grupet tjera të identifikuar nga OAK si qenësore për synimet e veta lobuese për përcjelljen e progresit mbi çështjet ekzistuese që janë lobuar dhe të ngriten çështjet tjera dhe të reja.
- OAK ofron komente/analiza të hollësishme mbi propozim ligjet dhe mbanë takime me ministrinë përkatëse për prezantimin e komenteve/analizave dhe/ose anëtarëve të parlamentit mbi komitetet relevante. Mbledhjet pasuese për përcjelljen e progresit mbi përfshirjen e kontributit të OAK-së.
- Fushata e suksesshme publicitare (gazetat/radiot/televizioni) për lartësimin/reklamimin e të mirave/avantazheve për shfrytëzimin e avokatit të regjistruar në OAK, para ofruesve tjerë dhe të pa-autorizuar të shërbimeve juridike.

<b>Pikët strategjike/të veprimit</b>	<b>Hapi i ardhëm</b>	<b>Përgjegjësia</b>	<b>Afati kohor/statusi</b>	<b>Prioriteti/buxheti</b>
1. Konvokimi i komitetit për lobim dhe çështje legjislative	(i) Vendimi mbi mënyrën e caktimit të detyrave për anëtarët e komiteteve ekzistuese dhe se a duhet të rekrutohet ndihmë nga anëtarët e jashtëm dhe të	Kryesuesi i komitetit për çështje legjislative ose kryetari i OAK-së	Qershor 2009	Prioritet i lartë Të financohet nga buxheti i qëndrueshëm

	identifikohen ata ose të krijohet komiteti i ri ose nën-komitetet.			
2. Në vijim të nr. 1 si më lart, komiteti duhet të identifikojë dhe t'ua caktojë prioritetin pikëve që kërkojnë lobim dhe duhet të ndërtojë procesin/procedurën e lobimit.	<p>Shënim: nga diskutimi gjatë mbledhjes është e qartë se ka kërcënime të jashtme dhe çështje tjera me të cilat ballafaqohet OAK:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Licencimi/regjistrimi</li> <li>• Ligji i pa-miratuar mbi ndihmën juridike</li> <li>• Sistemi disiplinor</li> <li>• Çështja e përfaqësimit ex-officio</li> <li>• Përpjekjet e MTI-së për regjistrimin e OAK-së</li> <li>• Ushtrimi i profesionit nga personat të cilët nuk janë të regjistruar nga OAK</li> <li>• Ulësja (vendi) i OAK-së në KGJK nuk është garantuar gjatë kalimit nën mbikëqyrjen e EULEX-it</li> <li>• Shqyrtimi i rekomandimeve nga</li> </ul>	Komiteti, që i raporton kryetarit të OAK-së në instancën e parë me raportin që i bëhet gjithashtu edhe organit ligjvënës.	Baza të rregullta, <i>p.sh.</i> , mbledhjet mujore	Prioriteti i lartë

	“Vlerësimi i ABA-së për odën autoritative (rregullative) nga prof. B. Powell			
3. Ndarja e detyrave lobuese për anëtarët; identifikimi dhe përkufizimi i masave lobuese që duhet marrë; caktimi afateve kohore dhe caktimi i raportimit të rregullt ose orarit të mbledhjeve për llogaridhënie.	(i) Kontaktimi i këshillave tjera evropiane dhe/ose të Amerikës Veriore për diskutimin e qasjeve të tyre.  (ii) Marrja parasyshe e kapaciteteve ekzistuese/talentit brenda p.sh., OAK/ <i>Praktikant</i> /Studentë të Universitetit.	Komiteti për çështje legjislative.	Rregullisht	
4. Ofrimi i trajnimit, edukimit, hulumtimit për (i) lobim dhe (ii) shqyrtim legjislativ dhe hartim (shkrim).			Shtator 2009	Prioritet i lartë
5. Krijimi i mekanizmave për ndikimin në shkrimin e ligjeve.	(i) OAK të fillojë shqyrtimin/komentimin dhe analizimin e propozim ligjeve.  (ii) Fillimi i kontakteve me ministritë dhe anëtarët e parlamentit nga këndi i prezantimit të komenteve dhe analizave të OAK-së		Qershor 2009  Shtator 2009	Prioritet i lartë

**Rezultati Strategjik 3: Disiplina dhe Etika**

**Grupi Punues: Komiteti për Etikë**

**Definicionet e Suksesit:**

- Efikasiteti i shtuar në procedimin e ankesave disiplinore:
  - Procedura disiplinore e efektshme;
  - Struktura e komitetit e thjeshtësuar dhe konsoliduar;
  - Hapësirë e veçantë e planifikuar për sistemin disiplinor;
  - Stafi profesional i planifikuar për sistemin disiplinor.
- Transparenca e shtuar në procedimin e ankesave disiplinore:
  - Rezultatet e gjykimeve disiplinore të publikuara sipas udhëzimeve të OAK-së;
  - Dëgjimet publike të procedurave disiplinore.

<b>Pikët strategjike/të veprimit</b>	<b>Hapi i ardhëm</b>	<b>Përgjegjësia</b>	<b>Afati kohor/statusi</b>	<b>Prioriteti/buxheti</b>
1. T'i caktohet detyra komitetit të shqyrtojë dhe të bëjë rekomandime lidhur me rregullimin e sistemit disiplinor dhe që OAK ta finalizojë këtë çështje.	(i) Ndarja e detyrave për anëtarë të caktuar që të rekomandojnë ndryshimet e Kodit të Etikës, procesit disiplinor të OAK-së dhe strukturën e komitetit për disiplinë me qëllim të bërjes së procedurës së ankimit dhe asaj disiplinore sa më efikase dhe transparente. Komiteti duhet të merr parasysh: <ul style="list-style-type: none"><li>• Konsolidimin e</li></ul>	Komiteti për etikë dhe disiplinë	2011	Prioritet mesatar  Të financohet nga buxheti i tanishëm, buxheti i qëndrueshëm



	<p>dispozitave që rregullojnë sistemin disiplinor të OAK-së në një grup rregullash</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i udhëzimeve për publikimin e vendimeve disiplinore</li> <li>• Zgjidhja e ankesave disiplinore mbi bazat materiale dhe jo procedurale</li> <li>• Bërja publike e procedurave disiplinore</li> <li>• Shqyrtimi i gjyqësor i vendimeve disiplinore nga Gjykata Supreme e Kosovës</li> <li>• Proceset formale për zgjidhjen e shkeljeve të parëndësishme disiplinore</li> <li>• Metodë e re për raportimin vjetor mbi gjendjen e sistemit disiplinor të avokatëve dhe për</li> </ul>		2011	Prioritet mesatar
--	---	--	------	-------------------

	<p>rekomandimin e përmirësimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sigurohet që rregullat procedurale dhe të provuarit që zbatohen në procedurën e zbatueshme administrative, të zbatohen në procedurën disiplinore për avokatë dhe që standardi i të provuarit të jetë qartë provat bindëse.</li> <li>• Trajnimi vjetor i stafit të OAK-së lidhur me procedurën disiplinore për avokatë</li> <li>• Shqyrtimi i rekomandimeve tjera nga vlerësimi i odës rregullative të profesor B. Powell.</li> </ul> <p>(ii) Bordi Ekzekutiv i OAK-së duhet t'u caktojë detyrë komiteteve të duhura:</p>		2011	Prioritet mesatar
--	--	--	------	-------------------

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i vijës së pavarur buxhetore për çështjet e etikës dhe disiplinës.</li> <li>• Hartimi i planit dhe afateve kohore për sigurimin e dhomës së veçantë ose zyrës për shfrytëzim nga stafi dhe komitetet që përbënin sistemin disiplinor.</li> <li>• Marrja parasysht e mundësisë së sigurimit e së paku një këshilltari të paguar për sistemin disiplinor.</li> </ul>	Bordi ekzekutiv	Shkurt 2010  Dhjetor 2010  Dhjetor 2010	Prioritet i lartë  Prioritet i lartë  Prioritet i lartë
2. Hartimi i programeve për trajnime plotësuese mbi Kodin e Etikës, shkeljet dhe dënimet.	(i) Hartimi i planit për mbikëqyrjen e trajnimit në etikë për avokatët dhe <i>praktikantët</i> , duke përfshirë zhvillimin e	Komiteti për etikë dhe/ose AVL	Janar 2010	Prioritet mesatar  Të financohet nga buxheti i qëndrueshëm

	<p>vazhdueshëm të trajnimeve mbi Kodin e Etikës, shkeljet, dënimet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi i minimumit vjetor për arsimimin e vazhdueshëm ligjor mbi etikën dhe kjo të bëhet e obligueshme</li> <li>• Zhvillimi i trajnimeve plotësuese për avokatët dhe <i>praktikantët</i> mbi aspektet e kodit të etikës, duke përfshirë sjelljen e duhur të avokatëve, standarde e kujdesit për klientë dhe të ngjashme</li> </ul> <p>(ii) Hartimi i trajnimeve për avokatët lidhur me sjelljet e duhura për anëtarët e profesionit (mundet gjithashtu të përfshihet në programin për <i>praktikantët</i> për të regjistruarit e ri)</p>		<p>Qershor 2009</p> <p>Janar 2010</p>	<p>Prioritet i lartë</p> <p>Prioritet mesatar</p>
--	---	--	---------------------------------------	---

	(iii) Hartimi i trajnimit për avokatë lidhur me standardet e duhura për punën me klientë dhe standardet për marrëdhëniet me klientë (mundet gjithashtu të përfshihet në programin për <i>praktikantët</i> për të regjistruarit e ri).			
--	---	--	--	--

**Rezultati Strategjik 4:** Ekselenca Ligjore

**Grupi Pnues:** AVL; Komiteti për etikë dhe praktikant

**Definicioni i Suksesit:** TP (të përcaktohet). Për shembull:

- Përcaktimi i standardit minimal të obligueshëm të arsimimit të vazhdueshëm ligjor për avokatë.
- Përcaktimi i programit për ofrimin e AVL-së të mjaftueshëm për avokatët që t'i plotësojnë kushtet minimale.
- Arritja e marrëveshjes mbi kriteret për hyrjen në programin për praktikantë: *p.sh.*, (i) vërtetimi se praktikanti për marrjen pjesë dhe dhënien e provimit të jurisprudencës dhe (ii) se kandidati për praktikant e ka siguruar vendin e punës në zyrën e një avokature të hapur që më parë (*p.sh.*, me jo më pak se dhjetë vite të përvojës totale si avokat i OAK-së) për kohëzgjatjen e periudhës së praktikantit.
- Arritja e marrëveshjes mbi kriteret për programin për praktikantë, *p.sh.*, elementet themeluese të përmbushen para regjistrimit të plotë si avokat i OAK-së: (i) përcaktimi i kohës që duhet shërbyer si praktikant para pranimit të plotë si avokatë i OAK-së (*p.sh.*, 1.5 vite) dhe (ii) dhe obligimi i praktikantit në kurse edukative në qendrën edukative.

Pikët strategjike/të veprimit	Hapi i ardhëm	Përgjegjësia	Afati kohor/statusi	Prioriteti/buxheti
1. Trajnimi/arsimimi për praktikantë.	(i) Caktimi i detyrës për nën-komitetin që të merret me trajnimin e të regjistruarve/praktikantëve të rinj.  (ii) Caktimi i kriterëve për regjistrim në programin	Komiteti për praktikantë	Janar 2011	Prioritet mesatar  Të financohet nga buxheti i qëndrueshëm

	<p>për <i>praktikantë</i> të OAK-së.</p> <p>(iii) Caktimi i kritereve për programin për <i>praktikantë</i>.</p> <p>(iv) Projektimi i kursit arsimor për programin për praktikantë.</p>			
2. Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të obligueshëm të arsimimit të vazhdueshëm ligjor	<p>(i) Puna me ABA ROLI-n për hartimin dhe miratimin e programit të obligueshëm AVL duke përfshirë edhe orarin vjetor të AVL-së, sistemin e caktimit dhe përcjelljes së kredive të AVL-së</p> <p>(ii) Puna me ABA ROLI-n për hartimin dhe programit për ofrimin efikas të trajnimeve AVL për avokatët anekënd Kosovës.</p>	Komiteti i AVL-së dhe/ose komisioni i ri për AVL-në e obligueshme	Qershor 2009	<p>Prioritet i lartë</p> <p>Të financohet nga buxheti i qëndrueshëm</p> <p>Financimi i implementimit TP (të përcaktohet)</p>
3. Diploma mbi temat e specializuara (vërejtje, kjo ndërlidhet me .2 (AVL) si më lart).	(i) Përcaktimi i temave/fushave për specializim dhe planprogramin për secilën	Komiteti i AVL-së ose nën-komiteti i veçantë	Janar 2012	<p>Prioritet i ultë</p> <p>Mjetet buxhetore TP</p>

	<p>diplomë.</p> <p>(ii) Caktimi i detyrës për komitetin që t'i adresojë çështjet e testimit dhe akreditimit.</p>			
4. Promovimi i standardeve më të larta	<p>(i) Caktimi i standardeve për arsimim profesional</p> <p>(ii) Ngritja e shkallës së njohurive praktike/ mëso si – për avokatët praktikues</p>	Komiteti për AVL	Duke vazhduar	
5. Vlerësimi i standardeve për regjistrim në OAK.	<p>(i) Pjesëmarrja në kursin për avokatë</p> <p>(ii) Testimi i njohurive profesionale.</p>	TP (të përcaktohet)	2011	Mesatare



**Rezultati Strategjik 5 :** Shërbimet dhe zhvillimet e përmirësuara në anëtarësinë e OAK-së

**Grupi Punues:** Komiteti i ri për shërbimet dhe zhvillimin e anëtarësisë; komiteti për çështje gjinore dhe pakica; Bordet redaktuese

**Definicioni i Suksesit:**

- Rritja e numrit të anëtarëve femra dhe të pakicave
- Anëtarët jo-avokatë i bashkohen OAK-së
- Mbledhjet e rregullta regjionale
- Sigurimi i përfitimeve për anëtarët e OAK-së, siç janë çmimet e ulëta nga shitësit
- Publikimi dhe shpërndarja konsistente e publikimeve të OAK-së
- Ueb-faqja e freskuar rregullisht duke përfshirë materialet dhe informatat relevante për avokatë dhe laikët

<b>Pikët strategjike/të veprimit</b>	<b>Hapi i ardhëm</b>	<b>Përgjegjësia</b>	<b>Afati kohor/statusi</b>	<b>Prioriteti/buxheti</b>
1. Shërbime të forcuara të anëtarësisë dhe reforma	Formimi i komitetit të anëtarësisë për zhvillim dhe shërbime të OAK-së, anëtarët e të cilit janë presidentët e organizatave regjionale dhe që ky komitet të ketë për detyrë: Hartimin dhe zbatimin e programit për mbledhjet e rregullta për secilën nga organizatat	Komiteti i anëtarësisë për ZH & SH (për zhvillim dhe shërbime) me komitetin për AVL	Qershor 2010	Prioritet i lartë  Të financohet nga buxheti i qëndrueshëm/ose pagesat nga anëtarësia

	<p>regjionale. Shqyrtimi i modelit për mëngjese, dreka ose darka të rregullta dhe njëkohësisht mbledhje nëpër restorantet lokale nëpër secilin regjion, kombinuar me programet AVL në bashkëpunim me komitetin për AVL.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizojë rithemelimin e kuvendit vjetor për të gjithë anëtarët e OAK-së, planifikojë dhe organizojë të njëjtin</li> <li>• Shqyrtojë dhe rekomandojë para bordit ekzekutiv të OAK-së, reformat e kushteve për anëtarësim në OAK, strukturës dhe obligimeve (pagesat). Në veçanti: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Çmimin e ulur</li> </ul> </li> </ul>	<p>Komiteti i anëtarësisë për ZH &amp; SH, Bordi ekzekutiv</p> <p>Komiteti i anëtarësisë për ZH &amp; SH, Bordi ekzekutiv, komiteti për çështje gjinore dhe pakica</p>	<p>Qershor 2010</p> <p>Qershor 2009</p>	<p>Prioritet mesatar</p> <p>Prioritet i lartë</p>
--	--	--	---	---

	<p>të anëtarësisë për anëtarët femra dhe nga pakicat</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ndërrimi i procesit të regjistrimit ashtu që avokatët të regjistrohen nëpër regjionet e veta dhe jo vetëm në Prishtinë</li> <li>○ Shqyrtimi i krijimit të kategorive të anëtarësisë pa të drejtë vote për profesionistët tjerë përveç avokatëve</li> </ul>		2011	Prioritet mesatar
	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përgatitja dhe zbatimi i procesit për lidhjen e “kontratave ekskluzive me përfitim të anëtarëve” me shitësit, tregtarët, dhe profesionistët tjerë që ofrojnë produkte dhe shërbime në</li> </ul>	Komiteti i anëtarësisë për ZH & SH,	2012	Prioritet i ultë

2. Ngritja e llojlojshmërisë së anëtarësisë	<p>përdorim të rregullt nga avokatët e OAK-së</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Avokimi dhe rekomandimi i: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Çmimit më të ulët të anëtarësisë për avokatët femra dhe nga pakicat</li> <li>○ Ndryshimi i regjistrimit ashtu që avokatët të regjistrohen në regjionet e veta</li> <li>○ Vazhdimi i zbatimit të garës vjetore për esenë më të mirë për femrat dhe studentët e drejtësisë nga pakicat</li> <li>○ Puna me ABA ROLI-n për krijimin e programit mentorues midis avokatëve të OAK-së dhe studentëve femra dhe nga pakicat</li> </ul> </li> </ul>	Komiteti për çështje gjinore dhe pakica	Qershor 2009	Prioritet i lartë
		Komiteti për çështje gjinore dhe pakica	Vjetore, fillimi i marsit 2009	Prioritet i lartë
		Komiteti për çështje gjinore dhe pakica	Duke vazhduar, fillimi i prillit 2009	Prioritet i lartë

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Gjurmimi me ABA ROLI-n të programeve të cilat ndihmojnë avokatët femra dhe nga pakicat në hapjen e avokaturave të tyre</li> <li>○ Gjurmimi me ABA ROLI-n të rrugëve për formimin e rrjeteve të grave me aspektet tjera të profesionit ligjor, <i>p.sh.</i>, gjykatës, prokurorë, profesorë të drejtësisë, studentë dhe juristë.</li> <li>○ Puna me komitetin për anëtarësi të sigurojë mundësitë për aktivitet lokale të avokaturës të cilat përfshijnë pakicat</li> <li>○ Shqyrtimi i ndarjes së komitetit të tanishëm në dy nën-komitete</li> <li>○ Hartimi i AVL-së për eliminimin e subjektivitetit nga gjyqësori</li> </ul>	<p>Komiteti për çështje gjinore dhe pakica</p> <p>Komiteti për çështje gjinore dhe pakica</p> <p>Komiteti për çështje gjinore dhe pakica</p> <p>Komiteti për çështje gjinore dhe pakica</p> <p>Komiteti për çështje gjinore dhe pakica</p>	<p>Mars 2009</p> <p>Duke vazhduar, fillimi i prillit 2009</p> <p>Duke vazhduar</p> <p>Qershor 2010</p> <p>Janar 2010</p>	<p>Prioritet i lartë</p> <p>Prioritet i lartë</p> <p>Prioritet i lartë</p> <p>Prioritet i ultë</p> <p>Prioritet i lartë</p>
--	---	--	--	---

3. Institucionalizimi i publikimeve të OAK-së	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Emërimi i redaktorit ose bordit redaktues për mbikëqyrjen e publikimit të <i>Buletinit</i>, krijimi dhe zbatimi i orarit të rregullt të publikimeve</li> </ul>	Komiteti i anëtarësisë për ZH & SH	Shtator 2010	Prioritet mesatar
	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Emërimi i redaktorit ose bordit redaktues për mbikëqyrjen e publikimit të <i>Avokatura</i>, krijimi dhe zbatimi i orarit të rregullt të publikimeve</li> </ul>	Komiteti i anëtarësisë për ZH & SH	Shtator 2010	Prioritet mesatar
	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Caktimi i detyrës një personi ose bordi të mbikëqyrë freskimin e rregullt dhe të përgjithshëm të përmbajtjes së ueb-faqes së OAK-së</li> </ul>	Komiteti i anëtarësisë për ZH & SH	Shtator 2010	Prioritet mesatar

**ORARI B: KALENDARËT VJETORË TË KOMITETEVE TË  
PËRZGJEDHURA**

## BORDI EKZEKUTIV 2009

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL/MAJ	QERSHOR	QERSHOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Reformimi i administratës së OAK-së: politika të reja të shkruara</li> <li>• Krijimi i komitetit për ngritje të fondeve për të përmirësuar mbledhjen obligimeve, etj.</li> <li>• Formimi i komitetit për zhvillim të anëtarësisë dhe shërbime që përfshinë kryetarët e të gjitha rajoneve për të sajuar takimet e rregullta rajonale, sugjeruar reformimin e anëtarësisë dhe mbikëqyrë publikimet e OAK-së</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi i nevojave personale, zhvillimi i hierarkisë, sistemit të mbikëqyrjes së stafit, përshkrimet e vendeve të punës</li> <li>• Propozimi për reformimin e administratës – para kuvendit nëse kjo kërkohet</li> <li>• Përcaktimi i orarit buxhetor vjetor</li> <li>• Zhvillimi i sistemit të shpenzimeve diskrecionale, për organet që të kërkojnë fonde</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrja parasysh e anëtarësisë më pak të përfaqësuar, gratë dhe pakicat</li> <li>• Ndryshimi i procesit të regjistrimit nëpër rajone Secili komitet i përfaqësuar në bordin ekzekutiv; politikat lidhur me pozitën e oficerit të komitetit, mbi zgjedhjen/largimin e anëtarit të komitetit</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i politikave financiare për shpërndarjen e fondeve, pagave, kompensimet afariste</li> <li>• Trajnim në çështjet e buxhetit dhe raportimit për komitetet dhe degët rajonale</li> </ul>			



## BORDI EKZEKUTIV 2010

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dhënia e trajnimit administrativ për stafin e paguar dhe vullnetarë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i buxhetit vjetor organizativ me gjithë kontributet nga komitetet, rajonet</li> <li>• Aprovimi i buxheteve vjetore për të gjitha komitetet dhe rajonet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i mëtutjeshëm i sistemit të komiteteve, raportimit vjetor, programimit, financimit para bordit ekzekutiv</li> <li>• Zhvillimi dhe publikimi i orarit vjetor të takimeve për të gjitha komitetet dhe rajonet</li> <li>• Zhvillimi i sistemit të raportimit financiar mujor dhe tremujor</li> </ul>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi me komitetin për anëtarësi ri-caktimin e mbledhjeve vjetore për të gjithë anëtarët e OAK-së</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
					<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i strukturave rajonale; sigurimi i objekteve, pajisjeve, personelit administrativ nëpër rajone; publikimi i vendeve të punës në rajone, intervistat, kontratat e personelit</li> <li>• Sajimi i planit për hapësirë të ndarë të punës për sistemin disiplinor</li> <li>• Shqyrtimi i mundësisë të angazhimit të këshillës së paguar për mbikëqyrjen e sistemit të disiplinës</li> </ul>

## KOMITETI PËR NGRITJEN E FONDEVE 2009

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i mbledhjes së obligimeve të anëtarësisë; politikat për mos-pagesë; sistemi i mbledhjes</li> </ul>			
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi i parë vjetor i parave të mbledhura, përmirësimet e sistemit</li> <li>• Gjurmime të mundësive alternative të ngritjes së fondeve</li> <li>• Trajnim në ngritjen e fondeve dhe për buxhet për komitetet dhe rajonet me Bordin Ekzekutiv.</li> </ul>			

## KOMITETI PËR NGRITJEN E FONDEVE 2010

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i programeve vjetore dhe buxhetit dhe prezantimi i tyre para Bordit Ekzekutiv për miratim</li> <li>• Gjurmime i vazhdueshëm i mjeteve alternative për ngritjen e fondeve</li> </ul>					
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi vjetor i mjeteve të mbledhura, përmirësimet në sistem</li> </ul>			

## KOMITETI PËR ÇËSHTJE GJONORE DHE PAKICA 2009

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gara vjetore për esenë më të mirë nga studentët e drejtësisë nga pakicat dhe femrat</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i programit mentorues midis studenteve të drejtësisë dhe ushtruesit e ligjit që përfshinë ngjarje të rregullta</li> <li>• Gjurmimi i mundësisë me ABA ROLI-n për një program për nxitjen e femrave në hapjen e zyrave të avokaturës</li> <li>• Gjurmimi i rrugëve për krijimin e rrjeteve të grave dhe pakicave edhe në rrafshet tjera të profesionit ligjor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Puna me Komitetin për Anëtarësi për të siguruar mundësitë për aktivitetet e odave lokale që përfshijnë pakicat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lobim për tarifë më të ultë të anëtarësisë për pakicat dhe femrat</li> <li>• Lobim për ndryshimin e procesit të regjistrimit në rajone</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja në trajnimin për buxhet të organizuar nga Bordi Ekzekutiv</li> </ul>			

## KOMITETI PËR ÇËSHTJE GJONORE DHE PAKICA 2010

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i programeve vjetore dhe buxhetit dhe prezantimi i tyre para bordit ekzekutiv për miratim</li> <li>• Zhvillimi i programit AVL për arsim të vazhdueshëm ligjor të obligueshëm, për paanshmërinë në sistemin gjyqësor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gara vjetore për esenë më të mirë nga studentët e drejtësisë nga pakicat dhe femrat</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i programit mentorues midis studenteve të drejtësisë dhe ushtruesit e ligjit sipas modelit në zhvillim e të projektit të grave për mentorim</li> <li>• Gjurmimi i mundësisë me ABA ROLI-n për programin për inkurajimin e pakicave për hapjen e zyrave të avokaturës sipas modelit të projektit të grave.</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shqyrtohet ndarja e komitetit në dy nën-komitete</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR

## LEGJISLATIV/LOBIM 2009

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
					<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe dhënia e detyrës për anëtarët e komiteteve; caktimi i orarit mujor të takimeve</li> <li>• Identifikimi dhe caktimi i çështjeve parësore për aktivitetin lobues, raportimi para drejtuesve të OAK-së lidhur me këtë aktivitet</li> <li>• Fillo shqyrtimin/komentimin dhe analizimin e propozim ligjeve</li> <li>• Përkufizo hapat lobues që duhet ndërmarrë, cakto afatet kohore</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnime, edukim dhe hulumtim mbi lobimin dhe shqyrtimin, hartimin e legjislacionit</li> <li>• Kontaktet me ministri, agjenci, parlament për të prezantuar komentet e OAK-së dhe analizat e saj</li> <li>• Pjesëmarrja në trajnimin për buxhet nga Bordi Ekzekutiv.</li> </ul>			

## LEGJISLATIV/LOBIM 2010

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i programit vjetor dhe buxhetit dhe prezantimi i tyre para bordit ekzekutiv për miratim</li> <li>• Vazhdimi me takimet mujore</li> <li>• Identifikimi dhe caktimi i prioriteteve për lobim dhe çështje legjislative për këtë vit</li> </ul>					
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR

## ZHVILLIM I ANËTARËSISË DHE SHËRBIME 2009

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
					<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rekomandimi për OAK-në të ofrojë tarifa më ulëta të anëtarësisë për pakicat dhe femrat anëtare</li> <li>• Rekomandimi për ndryshimin e procesit të regjistrimit nëpër rajone</li> <li>• Gjurmimi i ri-caktimit të takimeve vjetore për të gjithë anëtarët e OAK-së dhe planifikimi dhe drejtimi i të njëjtave</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja në trajnimin për buxhet të organizuar nga Bordi Ekzekutiv.</li> </ul>			



## ZHVILLIM I ANËTARËSISË DHE SHËRBIME 2010

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i programit vjetor dhe buxhetit dhe prezantimi para Bordit Ekzekutiv për miratim</li> </ul>					<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sajimi dhe implementimi i programit për takimet e rregullta rajonale</li> </ul>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Caktimi i redaktorit ose bordit redaktues mbikëqyrjen e publikimit të Buletinit; caktimi dhe implementimi i orarit të rregullt të publikimeve</li> <li>• Caktimi redaktorit ose bordit redaktues për mbikëqyrjen e “Avokatura”; caktimi dhe implementimi i orarit të rregullt të publikimit</li> <li>• Mbikëqyrja e azhurnimit të rregullt të përmbajtjes në ueb-faqen e OAK-së</li> </ul>			